## KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Sot me date 27.02.2019 (dymije e nentembedhjete), u redaktua kontrata e shitjes se kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise MUSA ALBANIA SHPK person juridik shqiptar rregjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me NUIS :**L81821024M** u paraqiten personat e identifikuar si ne vijim:

**SHITESI kuotave:**

- **BLG sh.p.k**, me seli ne Rr. Tercilio Kardinali, Njesia nr. 11, ndertesa 10, kati 2, shkalla 1, ap. 2, me NIPT L71603025P, e perfaqesuar nga perfaqesuesi i saj ligjor, **Z. Massimiliano Nicolini**, shtetas italian, i datelindjes 16.11.1976, lindur ne Brescia (Itali) me banim ne Tirane, madhor me zotësi te plote juridike,dhe për të vepruar, i pajisur me pasaporte nr. YA 1831944, e vlefshme deri me 01.03.2021, ne cilesine e ortakut te shoqerise Musa Albania shpk , i cilesuar ne vijim si **"Shitesi"**;

**BLERESI kuotave:**

- **IBC** , shoqeri e te drejtes italiane, e regjistruar si shoqeri individuale, me seli Via G.Borremans, 98/E 93100 Caltanissetta (CL), me nipt: **01721150850** e përfaqësuar nga **Z.MIRKO BAGNARA** lindur me date 04/12/1980 ne VARESE, Itali, rezident ne CALTANISSETTA via. G.BORREMANS.98/E, madhor me zotësi te plote juridike dhe për të vepruar, identifikimi i tij: Nr. i pasaportes/Leter njoftimit: AU 2895967, e vlefshme deri me date 04/12/2024 i cilesuar ne vijim si **"Bleresi"**

Palët si me sipër me vullnetin e tyre te lire vendosin si vijon:

IBC GROUP
di BAGNARA MIRKO
Via G. Borremans, n. 98/E
93100 CALTANISSETTA
Partita I.V.A. 01721150850
info@ibc-group.it www.ibc-group.it

**Neni 1 Objekti kontratës**

Ortaku themelues shoqeria BLG sh.p.k vendos ti shesë 1 kuote e cila perben 5% te kapitalit te shoqerise me vlere 1.300.000 leke qe zotëron ne Shoqërine Musa Albania Sh.p.k , Blerësve si ne vijim:

- Shoqeria **IBC,** I cili pranon te bleje kuotat qe shitesi zoteron ne Shoqerine Musa Albania sh.p.k.

**Neni 2 Çmimi dhe pagesa**

2.1 Çmimi i caktuar për shitjen e kuotave te shoqërisë është vlerësuar ne baze te vleres se kapitalit themelor, i cili eshte 26.000.000 leke, si pasoje shitësi shet kuotat blerësve si vijon:

- Shoqeria **IBC,** i blen kuotat ne masën 5% te kapitalit me vlere 1.300.000 leke .

Palët deklarojnë qe çmimi do te shlyhet me trasferte bankare brenda 5 dite pune nga nenshkrimi i kesaj kontrate.

2.1 Sipas nenit 33 te ligjit nr. 8438 te datës 28.12.1998, i modifikuar, palët caktojnë me marrëveshje dhe pranojnë qe Shitësi do te derdhe për llogari te tatimeve, ne baze te parashikimeve ligjore përkatëse, 15 % te tatim fitimit nga çmimi i shitjes se kuotave.

**Neni 3 Pronësia dhe transferimi i kuotave**

3.1 Pala shitëse i garanton palës blerëse se kuotat janë te lira nga çdo detyrim ligjor dhe financiar ndaj te treteve dhe për çdo pretendim qe mund te ngrëne te tretet ajo është e gatshme dhe e detyruar te paraqitet me kërkesën e palëve blerëse para gjithë organeve gjyqësore dhe administrative për te mbrojtur te drejtën e tij si pronar i ligjshëm i këtyre kuotave.

3.2 Pronësia e kuotave i transferohet blerësve ne momentin e nënshkrimit te kësaj kontrate shitblerje.

IBC GROUP
di BAGNARA MIRKO
Via G. Borremans, n. 98/E
93100 CALTANISSETTA
Partita IVA.: 01721150850
info@ibc-group.it www.ibc-group.it

Sa parashikuar ne dispozitat kontraktuese te mësipërme, ne përputhje me nenin 686 te Kodit Civil Shqiptar, Blerësit deklarojnë se pranojnë dhe miratojnë veçmas Nenin 2 (**Çmimi dhe pagesa**).

Me nenshkrimin e kesaj kontrate , shitesit , shoqeria BLG sh.p.k ortak themelues i shoqerise Musa Albania Sh.p.k zhvishet nga pronesia e 1 koute me perqindje 5% te kapitalit themeltar dhe bleresi **IBC,** behet zoterues i nje kuote me perqindje 5% te kapitalit fillestar.

**PALET KONTRAKTUESE**

| | |
|---|---|
| **PALA SHITESE** | **PALA BLERESE** |
| **BLG SHPK** | **IBC** |
| Z. Massimiliano Nicolini | Z. Mirko Bagnara |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BLG
L71603025P
ALBANIA

IBC GROUP
di BAGNARA MIRKO
Via G. Borremans, n. 98/E
93100 CALTANISSETTA
Partita I.V.A.: 01721150850
info@ibc-group.it www.ibc-group.it